

Komunat e Rajonit të Gjilanit

Profili Socio-Ekonomik

Ky botim është pjesë e Programit të Konzortiumit të OJQ-ve (ATRC, KIPRED, BIRN, SPRC, KCBS dhe D+) “Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm”.

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm"



Përgatitur nga: Lulzim Peci, Mentor Agani, Diedon Nixha dhe Valdrin Ukshini.

Copyright © 2019, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rrikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +381 38 542 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III. No.1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 542 778

Përmbajtja:

Përmbledhje Ekzekutive	4
Profili i Komunës së Gjilanit	7
Profili i Komunës së Kamenicës	13
Profili i Komunës së Vitisë	19
Profili i Komunës së Ranillugut	25
Profili i Komunës së Kllokotit	29
Profili i Komunës së Parteshit	34

Përmbledhje Ekzekutive

Qëllim i këtij profili të komunave të Rajonit të Gjilanit është që të përdoret si shtytje për hapjen e debatit publik, dhe t'i ndihmojë vendim-marrësit komunalë dhe kombëtarë në formulimin dhe zbatimin e politikave që do t'i adresojnë nevojat e popullatës rinore, gjegjësisht të grup-moshës 15-29 vjet.

Për këtë qëllim, KIPRED-i ka përmbledhur të dhënat për strukturën e popullatës dhe lëvizjet demografike, për nivelin dhe strukturën e arsimit, të kulturës dhe të sportit, shtrirjen e teknologjisë informative, strukturën religjioze, përfshirë këtu edhe numrin e objekteve dhe klerikëve fetarë, ekstremizmin e dhunshëm, nivelin e kriminalitetit, strukturën e popullatës sipas aktivitetit ekonomik, buxhetet komunale dhe mbështetjen që ato e ofrojnë për aktivitetet rinore, për komunat e Gjilanit, Vitisë, Kamenicës, si dhe për komunat rurale të Ranillugut, Klllokotit dhe të Parteshit.

Të dhënat tregojnë se shumica absolute e popullatës së grup-moshës 15-29 vjet të komunave të këtij rajoni jetojnë në pjesët rurale të këtyre komunave, me përjashtim të Komunës së Gjilanit. Nivelin më të lartë të arsimit për komunat urbane e ka Komuna e Gjilanit, dhe më pas vjen Komuna e Kamenicës dhe ajo e Vitisë – e cila qëndron më së dobëti në rajon, ndërsa te komunat rurale nivelin më të lartë të arsimit e ka Komuna e Ranillugut – e cila qëndron më së miri në rajon, dhe pastaj vjen Komuna e Parteshit dhe ajo e Klllokotit.

Infrastruktura kulturore dhe sportive për të rinjtë në këto komuna, me përjashtim të Gjilanit, është varfër, dhe ajo nuk i plotëson nevojat e kësaj grup-moshe të popullatës. Për sa i përket strukturës religjioze, shumica absolute e banorëve në komunën e Gjilanit, Vitisë dhe të Kamenicës (98%), janë deklaruar që i përkasin besimit Islam. Banorët e komunës së Ranillugut dhe Parteshit janë deklaruar të besimit Ortodoks (97%), ndërsa komuna e Klllokotit qëndron me përqindje përafërsisht të njëjtë në mes të deklaruarve që i përkasin besimit Islam dhe atij Ortodoks.

Në Komunën e Gjilanit, raporti xhami për banorë në fshatra është 1.1 xhami në 1000 banorë, ndërsa në qytet është 0.16 xhami në 1000 banorë, në Komunën e Vitisë ky raport është 0.83 xhami në 1000 banorë në fshatra, dhe 0.02 xhami në 1000 banorë në qytet, në Komunën e Kamenices, 3.9 xhami në 1000 banorë në fshatra, dhe 0.06 xhami në 1000 banorë në qytet.

Numri i individëve që u janë bashkangjitur luftrave të huaja, domethënë, organizatave terroriste në Irak dhe Siri, për Komunën e Gjilanit është 0.41 në 1000 banorë, për Komunën e Vitisë është 0.27 individë në 1000 banorë, për Komunën e Kamenicës është 0.13 individë në 1000 banorë, ndërsa në komunat e tjera të rajonit nuk janë shënuar raste të tilla. Në përgjithësi, gjendja ekonomike e këtyre individëve është kryesisht e dobët, dhe ata kryesisht kanë shkollim të ulët dhe mesëm.

Numri i veprave penale për 1000 banorë është më i larti në Komunën e Parteshit, të Gjilanit dhe të Klllokotit me 24.8, 16.3 dhe 15.2, ndërsa më i ulëti është në Komunën e Vitisë me 9.2, ndërsa në ate të Kamenicës dhe Ranillugut ky numër është 9.6 dhe 11 respektivisht.

Në Komunën e Gjilanit 4.7% e popullatës janë në gjendje të rëndë ekonomike, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërsa 5.90% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet, në Komunën e Vitisë 4.2% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 5.8% nga pensionet, në Komunën e Kamenicës 4.1% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 7.9% nga pensionet, në Komunën e Ranillugut 5.10% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 12.5% nga pensionet, në Komunën e Parteshit 3.4% jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 11.5% nga pensionet ndërkaq, gjendja më e rëndë është në Komunën e Klllokotit, ku 7.6% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 5.7% nga pensionet.

Për sa i përket shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve për kulturë, sport dhe rini, në Komunën e Gjilanit këto paraqesin 3.0% të vlerës së përgjithshme të shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve, në atë të Vitisë 1.62%, dhe të Kamenicës 9.95%, ndërsa në komunat e Ranillugut, Parteshit dhe Klllokotit nuk ka fare ndarje nga buxheti për të rinjët. Me përjashtim të Gjilanit, këto shpenzime as për së afërmi nuk i plotësojnë nevojat për aktivitetet jashtëshkollore të të rinjve të këtyre komunave, të cilët kanë në dispozicion një infrastrukturë të varfër, apo

edhe inekzistente komunale në fushën e sportit, kulturës dhe të aktiviteteve të tjera ekstra-kurrikulare. Në fund, në tabelën e mëposhtme është dhënë një pasqyrë e përmblendhur e të dhënave socio- ekonomike për komunitat e rajonit të Gjilanit.



	Gjilan	Kamenicë	Viti	Ranillug	Kllokot	Partesh
Popullata	80162	30750	47615	3810	2753	1730
Grup-mosha 15-29	27.5.%	27.2.%	27.1.%	23.40%	28.00%	26.90%
Qyteti	59.5.%	20.30%	10.50%	*	*	*
Fshati	40.5.%	79.7.%	89.50%	100%	100.00%	100.00%
Niveli i Arsimit						
Analfabetë (në 1000 banorë)	45	49	46	38	36	32
Pa shkollim fillor (në 1000 banorë)	100	114	118	104	103	83
Shkolla fillore (në 1000 banorë)	499	525	538	418	502	448
Shkolla e mesme (në 1000 banorë)	308	296	278	385	327	386
Studimet e larta (në 1000 banorë)	91	64	64	91	66	81
Institucione shkollore	52	33	39	10	5	8
Religioni						
Xhamitë	49	31	36	0	1	0
Klerikë Islam	44	25	32	0	0	0
Kisha Katolike	1	0	8	0	0	0
Klerikë Katolikë	3	0	4	0	0	0
Kisha protestante	1	0	0	0	0	0
Klerikë protestantë	4	1	0	0	0	0
Kisha ortodokse	6	7	2	9	4	3
Luftëtarë të Huaj Terroristë	33	4	13	*	*	*
Mosha mesatare	26.2	24.5	27.1	*	*	*
Niveli i Arsimit	Mesëm/Ulët	Ulët/Mesëm	Mesëm	*	*	*
Gjendja ekonomike	Dobët	Dobët	Dobët	*	*	*
Kriminaliteti (vepra penale/në 1000 banorë)	16.3	9.6	9.2	11	15.2	24.8
Gjendja ekonomike						
Popullata ekonomikisht aktive	43.6.%	36.7.%	40.00%	36.4.%	34.80%	35.00%
Të punësuar	54.4.%	51.2.%	52.00%	41.4.%	58.5.%	50%
Me ndihma sociale	4.70%	4.1%	4.2.%	5.1.%	7.60%	3.40%
Të varur nga pensioni	5.90%	7.9.%	5.8.%	12.5.%	5.70%	11.50%
Buxheti komunal (EUR)	25.5 milion	9.3 milion	11.4 milion	1.8 milion	1.2 milion	1.2 milion
Shpenzimet kapitale dhe subvencionet	22.3.%	11.70%	20.50%	28.8.%	26.40%	10.30%
Shpenzimet kapitale dhe subvencionet për kulturë, sport dhe rini	3.00%	9%	1.62.%	0%	0%	0%

Profili i Komunës së Gjilanit

Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga popullsia, Gjilani është komuna e gjashtë në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë që kjo komunë ka patur 90 mijë banorë, ndërkohë që deri në vitin 2018 kjo shifër ka rënë për 10 mijë banorë, domethënë, në 80 mijë.¹ Sipas përkatësisë etnike, 97.3% të banorëve të Gjilanit janë shqiptarë, 1% turq, 0.7% serbë, dhe 1% i përkasin grupeve etnike të tjera. Raporti gjinor i popullatës është 50.3% meshkuj, dhe 49.7% femra.



Kjo analizë është e përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta e paraqesin 27.5% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (26%), së bashku me 30-80 (46.5%)². Regjistrimi i popullsisë tregon që numri më i madh i të rinjëve në Komunën e Gjilanit (59.5%) jetojnë në qytet, ndërkaj, pjesa tjetër prej 40.5% jeton në 48 fshatrat e komunës.³

¹ Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku: <http://ask.rks.gov.net/media/4118/vlersimi-i-popullsisë-2017.pdf>

² Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³ Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat për popullatën mbi 10 vjet, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit, tregojnë se në 1000 banorë, 45 janë analfabetë, 100.1 nuk e kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 499.8 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 308.6 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 91.3 i kanë përfunduar studimet universitare dhe post-universitare.⁴

Komuna e Gjilanit ka gjithsej 52 institucione arsimore parashkollore, fillore dhe të mesme, me 1417 mësimdhënës, me një raport të shkollave prej 1.56 për 1000 banorë deri në moshën 19-vjeçare⁵. Në mars të vitit 2013, në Komunën e Gjilanit është themeluar Universiteti Kadri Zeka⁶, në të cilin studiojnë 3346 studentë⁷. Në këtë qytet janë hapur edhe kampuse të kolegjeve private, Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT)⁸, Kolegji Fama⁹ dhe Kolegji Arbëri,¹⁰ për numrin e studentëve të të cilëve nuk ka të dhëna të sortuara në domenin publik.

Në komunën e Gjilanit janë aktive 57 klube-shoqata sportive, 10 biblioteka, 4 shtëpi të kulturës, 10 ansamble kulturore, 1 teatër, 1 muze si dhe 4 shoqata kulturore-artistike. Momentalisht janë 3 objekte sportive ku klubet zhvillojnë aktivitetet e tyre, si Palestra e Sporteve "Bashkim Selishta-Petriti", Stadiumi i Qytetit si dhe Stadiumi ndihmës.¹¹

- **Teknologjia Informative**

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për shtrirjen e Internetit, shihet që në vitin 2011 qasje në Internet kanë patur 70% e popullsisë, ku përqindjet përkatëse për qytet dhe

⁴ Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁵ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Linku: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>.

⁶ Universiteti Kadri Zeka, <https://www.uni-gjilan.net/>

⁷ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Linku: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>

⁸ Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT). Linku: <https://www.ubt-uni.net/sq/ubt-tani-edhe-ne-gjilan/>

⁹ Kolegji Fama Gjilan. Linku: <http://kolegijfama-edu.org/gjilan/>

¹⁰ Kolegji Arberi Gjilan. Linku: <http://kugjilani.com/>

¹¹ Të dhëna nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Gjilanit, 23.01.2019.

për fshatra ishin 75% dhe 62.5%¹². Këto shifra nuk e pasqyrojnë gjendjen e sotme, ku kjo shtrirje me siguri se ka patur zgjerim të madh, falë sistemeve Wi-Fi dhe platformave të telefonisë mobile.

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 98.6% e popullatës së Komunës së Gjilanit janë deklaruar të besimit islam, ndërkaq, nga pjesa tjetër, të besimit ortodoks janë deklaruar 0.7%, të besimit katolik 0.05%, dhe 0.65% të tjerë janë personat pa përkatësi fetare, si dhe ata që kanë preferuar të mos përgjigjen.¹³

Në territorin e Komunës së Gjilanit janë funksionale 49 xhami, nëntë prej të cilave janë në qytet dhe 40 ndodhen në fshatra. Numri i klerikëve islamë është 44.¹⁴ Këtu duhet theksuar që vetëm në katër vitet e fundit, në territorin e kësaj komune në shërbim të besimtarëve islamë kanë hyrë 8 xhami të reja¹⁵. Raporti xhami për banorë në fshatra është 1.1 xhami për 1000 banorë, ndërkaq, në qytet 0.16 xhami për 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku njëra është humanitare, e dyta e të rinjëve, dhe e treta e grave¹⁶. Besimtarët katolikë në shërbim të tyre e kanë një kishë katolike dhe tre klerikë të lëshkvisë së Kosovës, besimtarët protestantë e kanë një kishë protestante dhe katër klerikë protestantë¹⁷, dhe besimtarët ortodoksë i kanë 6 kisha ortodokse¹⁸.

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak u janë bashkangjitur 33 individë nga komuna e Gjilanit, përkatësisht, 0.41 individë për 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë që ata kanë nivel të mesëm dhe të dobët të

¹² Penetrimi i Internetit te Ekonomitë Familjare (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e statistikave të Kosovës.

¹³ Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave te Kosovës.

¹⁴ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018

¹⁵ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Gjilan/Gnjilane Municipal Profile (2014).

¹⁶ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

¹⁷ Të dhëna nga lëshkvia e Kosovës, 19 korrik 2018, dhe Bashkësia e Kishës Protestante të Kosovës, 20 korrik 2018

¹⁸ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Gjilan/Gnjilane Municipal Profile (2018),

<https://www.osce.org/kosovo/13113?download=true>.

shkollimit, dhe se janë në një gjendje ekonomike të dobët. Mosha mesatare e tyre është 26.2 vjet.¹⁹

Edhe përkundrajt këtij numri mjaft të lartë të individëve nga komuna e Gjilanit që u janë bashkangjitur grupeve terroriste në Lindjen e Mesme, duhet të theksohet se Kuvendi Komunal i Gjilanit nuk ka evidencë publike që dëshmon se deri më tash është mbajtur qoftë edhe një mbledhje e vetme ku do të trajtohej ky problem i sigurisë²⁰. Po ashtu, duhet përmendur që me vendimin e Ministrisë së Administratës Publike të Kosovës, për shkak të dyshimit të veprimtarive të paligjshme, dy OJQ-ve me karakter fetar që kanë vepruar në këtë komunë, u është pezulluar veprimtaria, dhe atë organizatave "Iniciativa Qytetare Argumenti " dhe "Njeshmëria Gjilan".²¹ Për më tepër, Mekanizmi Referues i Komunës së Gjilanit, që është edhe i vetmi në Kosovë, që nga themelimi e deri në muajin maj 2018 i ka trajtuar me sukses shtatë raste, ndërsa trajtimi i dy rasteve të tjera nuk ka përfunduar me sukses, ku njëri prej tyre është proceduar në prokurori, dhe rasti tjetër ka mbetur në tentativë²².

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Gjilanit tregojnë që brenda vitit të kaluar (2018) në këtë Komunë janë kryer 1306 vepra penale²³, domethënë, 16.3 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që e pasqyron një nivel të lartë të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (704), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (423).²⁴

¹⁹ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 15 janar, 2019.

²⁰ Shih proces-verbalet e Kuvendit Komunal të Gjilanit, <https://kk-arkiva.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Assembly/Procesverbalet.aspx?>

²¹ Të dhëna nga Departamenti për OJQ, Ministria e Administratës Publike të Kosovës, 13 gusht, 2018.


²² Sekretariati I Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Raport mbi zbatimin e Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm në nivelin lokal (Vizita në Komuna), Maj 2018.

²³ Të dhëna nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjilan, Policia e Kosovës, 13 shkurt, 2019.

²⁴ Ibid.

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Gjilanit tregojnë se nga 66 mijë persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 43.6% janë ekonomikisht aktivë – dhe vetëm 54.4% e tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 56.4% e popullsisë mbi 15 vjet.²⁵ Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 38.1% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërsa 42.5% kanë deklaruar që kujdesen për familjen apo shtëpinë. Këtu duhet të ceket se 4.7% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 5.9% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.²⁶



- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin 2019, komuna e Gjilanit ka buxhet prej rreth 25.5 milionë euro. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare që përbëjnë rreth 82% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 18% të pjesës së mbetur Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet janë kategoria që e përbën rreth 60.5% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën

²⁵ Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

²⁶ Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

pjesë me rreth 14.5%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 20% e shumës totale.²⁷



Nëse analizojmë buxhetin në raport me investimet kapitale dhe subvencionet për përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, dhe më në veçanti, me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 27.5% të popullatës së Komunës së Gjilanit.

Në buxhetin e vitit 2018, vetëm 0.66% (170,000 Euro) e buxhetit total, parashihet të shpenzohet ashtu që të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo shumë është ekuivalent me 3.0% të shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve.²⁸

²⁷ Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>.



²⁸ibid.

Profili i Komunës së Kamenicës

Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga popullsia, Kamenica (Dardana) është komunë e vogël në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë që kjo komunë ka patur rreth 36 mijë banorë, ndërkohë që deri në vitin 2018 kjo shifër ka rënë për 6 mijë banorë, domethënë në 30 mijë.²⁹ Sipas përkatësisë etnike, 94.7% të banorëve të Kamenicës janë shqiptarë, 4.3% serbë dhe 1% u përkasin grupeve të tjera etnike. Raporti gjinor i popullatës është 51.4% meshkuj dhe 48.6% femra.



Kjo analizë është e përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta e paraqesin 27.2% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (24.6%), së bashku me 30-80 (48.2%)³⁰. Regjistrimi i popullsisë tregon që numri më i madh i të rinjëve në Komunën e Kamenicës (79.7%) jetojnë në 58 fshatrat e komunës, ndërkaj, pjesa tjetër prej 20.3% jeton në qytet.³¹

²⁹ Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku: <http://ask.rks.gov.net/media/4118/vlersimi-i-popullise-2017.pdf>

³⁰ Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³¹ Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat për popullatën mbi 10 vjet, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit tregojnë se në 1000 banorë, 49.3 janë analfabetë, 114.1 nuk kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 525 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 296.3 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 64.4 kanë përfunduar studimet universitare dhe post-universitare.³²

Komuna e Kamenicës i ka gjithsej 33 institucione arsimore parashkollore, fillore dhe të mesme, me 506 mësimdhënës, me një raport të shkollave prej 2.6 për 1000 banorë deri në moshën 19-vjeçare³³. Në komunën e Kamenicës janë 7 biblioteka publike³⁴, ndërsa të dhënat për kulturë dhe sport nuk janë në dispozicion në domenin publik, por po ashtu ato nuk janë vënë në dispozicion as përmes komunikimit zyrtar nga autoritet përgjegjëse komunale³⁵, gjë që e pamundëson një vlerësim të kësaj infrastrukture në raport me nevojat e rinisë.

- **Teknologjia Informative**

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për shtrirjen e Internetit, shihet që në vitin 2011 qasje në Internet kanë patur 52.5% e popullsisë, ku përqindjet përkatëse për qytet dhe për fshatra ishin 56.5% dhe 51.5%³⁶. Këto shifra nuk e pasqyrojnë gjendjen e sotme, ku kjo shtrirje me siguri se ka patur zgjerim të madh falë sistemeve Wi-Fi dhe platformave të telefonisë mobile.

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 95.3% e popullatës së Komunës së Kamenicës janë deklaruar të besimit islam, ndërkaq, nga pjesa tjetër, të besimit orodoks janë deklaruar 4.3%, të

³² Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³³ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Linku: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>.

³⁴ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Dardana> është i vetmi burim në dispozicion në domenin publik.

³⁵ KIPRED i ka dërguar kërkesë Drejtorisë Komunale për Kulturë Rini dhe Sport në formë të shkruar për të dhënat në lidhje me infrastrukturën kulturore dhe sportive, në datën 21 janar 2019, dhe më pas është komunikuar edhe disa herë, mirëpo deri në ditën e publikimit të raportit drejtoria në fjalë nuk i ka vënë në dispozicion të dhënat e kërkuara.

³⁶ Penetrimi i Internetit te Ekonomitë Familjare (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e statistikave të Kosovës.

besimit katolik 0.03%, dhe 0.37% të të tjerëve përfshijnë personat pa përkatësi fetare, si dhe ata që kanë preferuar të mos përgjigjen.³⁷

Në territorin e Komunës së Kamenicës janë funksionale 31 xhami, dy prej të cilave janë në qytet dhe 29 ndodhen nëpër fshatra. Numri i klerikëve islamë është 25.³⁸ Këtu duhet theksuar që vetëm në katër vitet e fundit, në territorin e kësaj komune në shërbim të besimtarëve islamë janë vënë 6 xhami të reja³⁹. Raporti xhami për banorë në fshatra është 3.9 xhami për 1000 banorë, ndërkaq, në qytet 0.06 xhami për 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku një është humanitare, një e të rinjëve, dhe një e grave⁴⁰. Besimtarët ortodoksë i kanë 7 kisha ortodokse,⁴¹ ndërkaq, kisha katolike dhe kisha protestante nuk ka.

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak u janë bashkangjitur 4 individë nga komuna e Kamenicës, përkatësisht 0.13 individë për 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë që ata kanë nivel të mesëm dhe të ulët të shkollimit, dhe se janë në një gjendje ekonomike të dobët. Mosha mesatare e këtyre individëve është 24.5 vjet.⁴²

Këtu duhet theksuar se nuk ka evidencë publike që dëshmon që Kuvendi Komunal i Kamenicës e kambajtur qoftë edhe një mbledhje të vetme për ta trajtuar këtë problem të sigurisë.⁴³

³⁷ Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³⁸ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

³⁹ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Kamenicë/Kamenica Municipal Profile (2014).

⁴⁰ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

⁴¹ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Kamenicë/Kamenica (2018), <https://www.osce.org/kosovo/13119?download=true>

⁴² Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 15 janar, 2019.


⁴³ Shih proces-verbalet e Kuvendit Komunal të Kamenicës, [https://kk-arkiva.rks-gov.net/kamenice/Municipality/Assembly/Procesverbalet-\(1\).aspx](https://kk-arkiva.rks-gov.net/kamenice/Municipality/Assembly/Procesverbalet-(1).aspx).

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në komunën e Kamenicës tregojnë që brenda vitit të kaluar (2018) në këtë komunë janë kryer 297 vepra penale,⁴⁴ domethënë, 9.6 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që e pasqyron një nivel mesatar të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (148), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (89).⁴⁵

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Kamenicës tregojnë se nga 27 mijë persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 36.7% janë ekonomikisht aktivë – dhe vetëm 51.2% e tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 63.3% e popullsisë mbi 15 vjet.⁴⁶ Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 32.9% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërsa, 47.6% kanë deklaruar që kujdesen për familjen apo

⁴⁴ Të dhëna nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjiçan, Policia e Kosovës, 13 shkurt, 2019.



⁴⁵ Ibid.

⁴⁶ Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

shtëpinë. Këtu duhet të përmendet që 4.1% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 7.9% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.⁴⁷

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin fiskal 2019 Komuna e Kamenicës e ka një buxhet prej 9.3 milion Eurosh. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare që përbëjnë rreth 86% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 14% të pjesës së mbetur Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet mbesin kategori që përbën rreth 76% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 10%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 10% e shumës totale.⁴⁸




Nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, më në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 27.2% të popullatës së Komunës së Kamenicës.

Në buxhetin e vitit 2018, vetëm 1.06% (100.000 Euro) e buxhetit total parashihet të shpenzohet në një asi mënyrë që të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në kuadrin e shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve, duke e paraqitur 9% të këtyre shpenzimeve. Për më

⁴⁷ Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁴⁸ Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>.

tepër, 30% e kësaj shume është e dedikuar për subvencione dhe transfere, ndërsa 70% për shpenzime kapitale⁴⁹.





⁴⁹Ibid.

Profili i Komunës së Vitisë

Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga popullsia, Vitia është komunë e mesme në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 tregojnë që kjo komunë ka patur rreth 46987 banorë, ndërkohë që deri në vitin 2018 kjo shifër është shtuar për 628 banorë, domethënë, në 47615.⁵⁰ Sipas përkatësisë etnike, 99.3% të banorëve të Vitisë janë shqiptarë, 0.25% serbë dhe 0.45% i përkasin grupeve të tjera etnike. Raporti gjinor i popullatës është 50.4% meshkuj dhe 49.6% femra.



Kjo analizë është e përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta e paraqesin 27.1% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (30.1%), së bashku me 30-80 (42.8%)⁵¹. Regjistrimi i popullsisë tregon që numri më i madh i të rinjëve në Komunën e Vitisë (88%) jeton në 38 fshatrat e komunës, ndërkaj, pjesa tjetër prej 12% jeton në qytet.⁵²

⁵⁰ Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku: <http://ask.rks.gov.net/media/4118/vlersimi-i-popullsisë-2017.pdf>

⁵¹ Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁵² Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat për popullatën mbi 10 vjet, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit tregojnë që në 1000 banorë, 46 janë analfabetë, 118.5 nuk e kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 538.8 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 278.5 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 64.2 i kanë përfunduar studimet universitare dhe post-universitare.⁵³

Komuna e Vitisë i ka gjithsej 39 institucione arsimore parashkollore, fillore dhe të mesme, me 696 mësimdhënës, me një raport prej 2 shkollave për 1000 banorë deri në moshën 19-vjeçare⁵⁴. Në komunën e Vitisë janë 14 klube sportive, 7 shtëpi kulturore si dhe 1 objekt sportiv i cili gjendet në qytetin e Vitisë, dhe në kuadër të institucioneve arsimore dhe të hapësirave publike janë gjithsej 21 fusha sportive⁵⁵.

- **Teknologjia Informative**

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për shtrirjen e Internetit, shihet që në vitin 2011 qasje në Internet kanë patur 48.5% e popullsisë, ku përqindjet përkatëse për qytet dhe për fshatra ishin 54% dhe 48%⁵⁶. Këto shifra nuk e pasqyrojnë gjendjen e sotme, ku kjo shtrirje me siguri se ka patur zgjerim të madh falë sistemeve Wi-Fi dhe platformave të telefonisë mobile.

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 94.4% e popullatës së Komunës së Vitisë janë deklaruar të besimit islam, ndërkaq, nga pjesa tjetër, të besimit katolik janë deklaruar 5.1%, të besimit

⁵³ Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁵⁴ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Linku: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>.

⁵⁵ Të dhëna nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë, 23 janar 2019.

⁵⁶ Penetrimi i Internetit në Ekonomitë Familjare (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

ortodoks 0.2%, dhe 0.3% të tjerëve përfshijnë personat pa përkatësi fetare, si dhe ata që kanë preferuar të mos përgjigjen.⁵⁷

Në territorin e Komunës së Vitisë janë funksionale 36 xhami, prej të cilave një është në qytet dhe 35 ndodhen në fshatra. Numri i klerikëve islamë është 32.⁵⁸ Këtu duhet theksuar që vetëm në katër vitet e fundit, në territorin e kësaj komune në shërbim të besimtarëve islam janë vënë 6 xhami të reja⁵⁹. Raporti xhami për banorë në fshatra është 0.83 xhami për 1000 banorë, ndërkaq, në qytet 0.02 xhami për 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku një është humanitare, një e të rinjëve, dhe një e grave⁶⁰. Besimtarët katolikë në shërbim të tyre e kanë tetë kisha katolike dhe katër klerikë të Ipeshkvisë së Kosovës⁶¹, ndërkaq, besimtarët ortodoksë i kanë 2 kisha ortodokse⁶²

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak u janë bashkangjitur 13 individë nga komuna e Vitisë, përkatësisht 0.27 individë për 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë që ata kanë nivel të mesëm të shkollimit, dhe se janë në një gjendje ekonomike të dobët. Mosha mesatare e këtyre individëve është 27.1 vjet.⁶³ Edhe përkundrejt këtij numri mjaft të lartë të individëve nga komuna e Vitisë që u janë bashkangjitur grupeve terroriste në Lindjen e Mesme, duhet të theksohet që Kuvendi Komunal i Vitisë nuk ka evidencë publike që dëshmon se deri më tash është mbajtur qoftë edhe një mbledhje e vetme për ta trajtuar këtë problem të sigurisë⁶⁴

⁵⁷ Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁵⁸ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

⁵⁹ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Viti/Vitina Municipal Profile (2014).

⁶⁰ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

⁶¹ Të dhëna nga Ipeshkvia e Kosovës, 19 korrik 2018.

⁶² Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Viti/Vitina (2018),

<https://www.osce.org/kosovo/13133?download=true>.

⁶³ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 15 janar, 2019.


⁶⁴ Shih proces-verbalet e Kuvendit Komunal të Vitisë, <https://kk.rks-gov.net/viti/category/kuvendi/procesverbalet/>.

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Vitisë tregojnë që brenda vitit të kaluar (2018) në këtë Komunë janë kryer 438 vepra penale,⁶⁵ domethënë, 9.2 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që e pasqyron një nivel mesatar të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (200), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (155).⁶⁶

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Vitisë tregojnë se nga 32 mijë persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 40% janë ekonomikisht aktivë – dhe vetëm 51.2% e tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 60% e popullsisë mbi 15 vjet.⁶⁷ Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 38.1% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërsa 42.5% deklarohen që kujdesen për familjen apo shtëpinë.

⁶⁵ Të dhëna nga Drejtoria e Rajonale e Policisë në Gjiilan, Policia e Kosovës, 13 shkurt, 2019.



⁶⁶ Ibid.

⁶⁷ Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Këtu duhet të ceket se 4.2% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 5.8% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.⁶⁸

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin 2019 komuna e Vitisë e ka një buxhet prej rreth 11.4 milion Eurosh. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare që përbëjnë rreth 90% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 10% të pjesës së mbetur Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet mbesin kategori që përbën mbi 64% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 13%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 18% e shumës totale.⁶⁹



Nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, më në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 27.1% të popullatës së Komunës së Vitisë.

⁶⁸ Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁶⁹ Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>.

Në buxhetin e vitit 2018, vetëm 0.33% (38,000 Euro) e buxhetit total parashihet të shpenzohet ashtu që të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo shumë është ekuivalente me 1.62% të shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve.⁷⁰


⁷⁰ Ibid.

Profili i Komunës së Ranillugut

Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga popullsia, Ranillugu është komunë e vogël në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 tregojnë që kjo komunë ka patur 3866 banorë, ndërkohë që deri në vitin 2018 kjo shifër ka rënë për 56 banorë, domethënë, në 3810.⁷¹ Sipas përkatësisë etnike, rreth 95.5% të banorëve të Parteshit janë serbë, 4.2% shqiptarë dhe 0.3% i përkasin grupeve të tjera etnike. Raporti gjinor i popullatës është 51% meshkuj dhe 49% femra.



Kjo analizë është e përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta e paraqesin 23.5% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (17 %), së bashku me 30-80 (59.5%)⁷².

⁷¹ Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku: <http://ask.rks.gov.net/media/4118/vlersimi-i-popullise-2017.pdf>.

⁷² Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat për popullatën mbi 10 vjet, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit tregojnë se në 1000 banorë, 38 janë analfabetë, 104.8 nuk e kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 418.2 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 385.5 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 91.5 i kanë përfunduar studimet universitare dhe post-universitare.⁷³

Komuna e Ranillugut ka gjithsej 10 institucione arsimore parashkollore, fillore dhe të mesme, me 115 mësimdhënës të cilat mësimin e ndjekin në bazë të kurikulës serbe.⁷⁴ Për këtë komunë nuk ka të dhëna që janë në dispozicion në domenin publik për infrastrukturën e kulturës dhe sportit.

- **Teknologjia Informative**

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për shtrirjen e Internetit, shihet që në vitin 2011 qasje në Internet kanë patur 25% e popullsisë⁷⁵. Kjo shifër nuk e pasqyron gjendjen e sotme, ku kjo shtrirje me siguri se ka patur zgjerim të madh falë sistemeve Wi-Fi dhe platformave të telefonisë mobile.

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze 95.5% e popullatës së Komunës së Ranillugut janë deklaruar të besimit orodoks, 4.2% janë deklaruar të besimit islam ndërkaq 0.3% të tjerë përfshijnë personat pa përkatësi fetare, si dhe ata që kanë preferuar të mos përgjigjen.⁷⁶

Në territorin e Komunës së Ranillugut janë funksionale 9 kisha ortodokse⁷⁷, ndërsa objekte tjera fetare nuk ka.

⁷³ Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁷⁴ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Ranillug/Ranilug (2018), <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/88760?download=true>.

⁷⁵ Penetrimi i Internetit te Ekonomitë Familjare (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e statistikave të Kosovës.

⁷⁶ Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave te Kosoves.

⁷⁷ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Ranillug/Ranilug (2018), <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/88760?download=true>.

- **Ekstremizmi i dhunshëm**


Në komunën e Ranillugut nuk është shënuar asnjë rast i bashkangjijtes së qytetarëve të kësaj komune grupeve terroriste në Lindjen e Mesme.

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Ranillugut tregojnë që brenda vitit të kaluar (2018) në këtë Komunë janë kryer 42 vepra penale,⁷⁸ domethënë, 11 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që e pasqyron një nivel mesatar të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (16), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (12).⁷⁹

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Ranillugut tregojnë se nga 3211 persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 36.4% janë ekonomikisht aktivë – dhe vetëm 41.4% e tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 63.6% e popullsisë mbi 15 vjet.⁸⁰ Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



⁷⁸ Të dhëna nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjiçan, Policia e Kosovës, 13 shkurt, 2019.



⁷⁹ Ibid.

⁸⁰ Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 28.7% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërsa 27.3% deklarohen që kujdesen për familjen apo shtëpinë. Këtu duhet të ceket se 5.1% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 12.5% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.⁸¹

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin 2019, komuna e Ranillugut ka buxhet prej rreth 1.8 milionë eurosh.⁸² Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga dhëniet qeveritare që përbëjnë rreth 93% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 7% të pjesës së mbetur Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet janë kategori që përbën rreth 57% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 12.5%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 26.6% e shumës totale.⁸³



Nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, më në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 23.5% të popullatës së Komunës së Ranillugut.

⁸¹ Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁸² Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>.


⁸³ Ibid.

Profili i Komunës së Kllokotit

Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga popullsia, Kllokoti është komunë e vogël në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 tregojnë që kjo komunë ka patur 2556 banorë, ndërkohë që deri në vitin 2018 kjo shifër është shtuar për 197 banorë, domethënë, në 2753.⁸⁴ Sipas përkatësisë etnike, në bazë të të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (2011), 53.2% të banorëve të Kllokotit janë shqiptarë, 46% serbë dhe 0.8% i përkasin grupeve të tjera etnike. Raporti gjinor i popullatës është 51.5% meshkuj dhe 49.5% femra.



Kjo analizë është e përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta e paraqesin 28% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (26.2%), së bashku me 30-80 (45.8%)⁸⁵.

⁸⁴ Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku: <http://ask.rks.gov.net/media/4118/vlersimi-i-popullise-2017.pdf>

⁸⁵ Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit**

Të dhënat për popullatën mbi 10 vjet, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit, tregojnë se në 1000 banorë, 36 janë analfabetë, 103.5 nuk kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 502.5 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 327.3 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 66.7 i kanë përfunduar studimet universitare dhe post-universitare.⁸⁶

Komuna e Kllkotit ka gjithsej 5 institucione arsimore parashkollore, fillore dhe të mesme me 55 mësimdhënës. Të gjitha këto institucione arsimore mësimin e ndjekin në bazë të kurikulës serbe, me përjashtim të një shkolle fillore që funksionon me kurikulën për arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës.⁸⁷ Për këtë komunë nuk ka të dhëna që janë në dispozicion në domenin publik për infrastrukturën e kulturës dhe sportit.

- **Teknologjia Informativë**

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për shtrirjen e Internetit, shihet që në vitin 2011 qasje në Internet kanë patur 40% e popullsisë⁸⁸. Kjo shifër nuk e pasqyrojnë gjendjen e sotme, ku kjo shtrirje me siguri se ka patur zgjerim të madh falë sistemeve Wi-Fi dhe platformave të telefonisë mobile.

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, në bazë të të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (2011), 53.2% e popullatës së Komunës së Kllkotit janë deklaruar të besimit islam, ndërkaq të besimit ortodoks janë deklaruar 46.1%, dhe 0.7% të të tjerëve përfshijnë personat pa përkatësi fetare, si dhe ata që kanë preferuar të mos përgjigjen.⁸⁹

⁸⁶ Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁸⁷ OSCE Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Kllkot/Kllkot (2018), <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/88759?download=true>.

⁸⁸ Penetrimi i Internetit të Ekonomitë Familjare (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e statistikave të Kosovës.

⁸⁹ Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Në territorin e Komunës së Kllokotit janë funksionale 4 kisha ortodokse⁹⁰, ndërsa komuniteti musliman e ka në shërbim një xhami.⁹¹

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Në komunën e Kllokotit nuk është shënuar asnjë rast i bashkangjites së qytetarëve të kësaj komune grupeve terroriste në Lindjen e Mesme.

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Kllokotit tregojnë që brenda vitit të kaluar (2018) në këtë Komunë janë kryer 42 vepra penale,⁹² domethënë, 15.2 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që e pasqyron një nivel të lartë të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (21), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (14).⁹³

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Kllokotit tregojnë se nga 1886 persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 34.8% janë ekonomikisht aktivë – dhe vetëm 58.5% e tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 65.2% e popullsisë mbi 15 vjet.⁹⁴ Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.


⁹⁰ OSCE Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Kllokot/Klokot (2018), <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/88759?download=true>.

⁹¹ Ibid.

⁹² Të dhëna nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjilan, Policia e Kosovës, 13 shkurt, 2019.

⁹³ Ibid.

⁹⁴ Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.



Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 34.7% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërsa 48.5% deklarohen që kujdesen për familjen apo shtëpinë. Këtu duhet të ceket se 7.6% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 5.7% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.⁹⁵



- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin 2019, komuna e Kllokotit ka buxhet prej rreth 1.2 milionë eurosh.⁹⁶ Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare që përbëjnë rreth 89% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 11% të pjesës së mbetur Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet janë kategori që e përbën rreth 59.6% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 10.3%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 26% e shumës totale.⁹⁷

⁹⁵ Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDTA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁹⁶ Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>.

⁹⁷ Ibid.




Nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, më në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 28% të popullatës së Komunës së Kllokotit.

Profili i Komunës së Parteshit

Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga popullsia, Parteshi është komunë e vogël në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 tregojnë që kjo komunë ka patur 1787 banorë, ndërkohë që deri në vitin 2018 kjo shifër ka rënë për 57 banorë, domethënë, në 1730.⁹⁸ Sipas përkatësisë etnike, rreth 99.9% të banorëve të Parteshit janë serbë. Raporti gjinor i popullatës është 51.5% meshkuj dhe 48.5% femra.



Kjo analizë është e përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta e paraqesin 27% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (19%), së bashku me 30-80 (54%).⁹⁹

⁹⁸ Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku: <http://ask.rks.gov.net/media/4118/vlersimi-i-popullise-2017.pdf>.

⁹⁹ Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat për popullatën mbi 10 vjet, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit tregojnë se në 1000 banorë, 32 janë analfabetë, 83.9 nuk e kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 448.1 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 386.7 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 81.3 i kanë përfunduar studimet universitare dhe post-universitare.¹⁰⁰

Komuna e Parteshit ka gjithsej 8 institucione arsimore fillore dhe të mesme me 76 mësimdhënës të cilat mësimin e ndjekin në bazë të kurrikulës serbe. Për këtë komunë nuk ka të dhëna që janë në dispozicion në domenin publik për infrastrukturën e kulturës dhe sportit.

- **Teknologjia Informativë**

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për shtrirjen e Internetit, shihet që në vitin 2011 qasje në Internet kanë patur 23.5% e popullsisë.¹⁰¹ Kjo shifër nuk e pasqyron gjendjen e sotme, ku kjo shtrirje me siguri se ka patur zgjerim të madh falë sistemeve Wi-Fi dhe platformave të telefonisë mobile.

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze 99.9% e popullatës së Komunës së Parteshit janë deklaruar të besimit orodoks.¹⁰² Në territorin e Komunës së Parteshit janë funksionale 3 kisha ortodokse.¹⁰³

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Në komunën e Parteshit nuk është shënuar asnjë rast i bashkangjitjes së qytetarëve të kësaj komune grupeve terroriste në Lindjen e Mesme.

- **Niveli i kriminalitetit**

¹⁰⁰ Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

¹⁰¹ Penetrimi i Internetit të Ekonomisë Familjare (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e statistikave të Kosovës.


¹⁰² Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

¹⁰³ OSCE Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Partesh/Partes (2018), <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/88761?download=true>.

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Parteshit tregojnë që brenda vitit të kaluar (2018) në këtë Komunë janë kryer 43 vepra penale,¹⁰⁴ domethënë, 24.8 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që e pasqyron një nivel të lartë të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (21), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (15).¹⁰⁵

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Parteshit tregojnë se nga 1447 persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 35% janë ekonomikisht aktivë – dhe vetëm 49.9% e tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 65% e popullsisë mbi 15 vjet.¹⁰⁶ Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 33% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërsa 39.4% deklarohen që kujdesen për familjen apo shtëpinë. Këtu duhet të ceket se 3.4% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 11.5% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.¹⁰⁷

¹⁰⁴ Të dhëna nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjiilan, Policia e Kosovës, 13 shkurt, 2019.



¹⁰⁵ Ibid.

¹⁰⁶ Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

¹⁰⁷ Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore**

Për vitin 2019, komuna e Parteshit ka buxhet prej rreth 1.2 milionë eurosh.¹⁰⁸ Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga dhëniet qeveritare që përbëjnë rreth 95% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 5% të pjesës së mbetur Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet mbesin kategori që e përbën rreth 70% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 16%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 10% e shumës totale.¹⁰⁹



Nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, më në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 27% të popullatës së Komunës së Parteshit.

¹⁰⁸ Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>.

¹⁰⁹ Ibid.

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: " Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizim"

